



Lajmet e Fundit:

Bulqizë – Përndiqte dhe kërcënonte në mënyrë të vazhdueshme një shtetase, arrestohet në flagrancë nga Policia 29-vjeçari



Lajmet

11/03/2022

Tepelenë – Goditet një rast i veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve

Sekuestrohen 3 kilogramë e 75 gramë lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa dhe një armë gjahu pa lejen përkatëse.

Vihet në pranga poseduesi.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve të Paligjshme në DVP Gjirokastër, në vijim të punës për goditjen e aktivitetit kriminal në fushën e narkotikëve, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë policore se në fshatin Xhafaj, Memaliaj, shtetasi B. K. posedonte lëndë narkotike, ushtruan kontroll në banesën e tij.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit B. K., u gjetën 3.75 kg lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa dhe një armë gjahu pa lejen përkatëse.

Në përfundim të veprimeve hetimore u arrestua në flagrancë shtetasi B. K., banues në fshatin Xhafaj, Memaliaj.

Materialet në ngarkim të këtij shtetasi i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Gjirokastër arrestuan në flagrancë shtetasin M. R., 18 vjeç, banues në Gjirokastër, pasi dyshohet se ka vjedhur kabllo elektrike në një subjekt privat. Gjatë kontrollit fizik iu gjet dhe iu sekuestrua në cilësinë e provës materiale një përforcues grushti (dorezë metalike).

Materialet në ngarkim të këtij shtetasi i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, për veprat penale “Vjedhja” dhe “Mbajtja pa leje e armëve të ftohta”.

WhatsApp Share

Facebook Share

Twitter Share

LinkedIn Share

Email

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Lushnjë – Bllokuan rrugën duke mos lejuar kalimin e automjeteve në të dy senset e lëvizjes në aksin rrugor Fier-Rrogozhinë, procedohen penalisht 7 shtetas

DVP Vlorë/Arrestohen në flagrancë 2 shtetas dhe procedohen penalisht 27 të tjerë, për vepra të ndryshme penale ▶